

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARBEN

## NELA

07/23/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 18.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, z.Arben Nela, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 23.07.2018 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Arben Nela, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj.Xhensila Pine, znj. Etleda Çiftja relatore, znj. Valbona Sanxhaktari anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.